



www.isie.org.mk



**KRIJIMI I KRITEREVE PËR CILËSI NË SHKENCAT
SHOQËRORE NË FUNKSION TË PARANDALIMIT
TË
LARGIMIT TË TRURËVE NGA REPUBLIKA E
MAQEDONISË**

DOKUMENT PËR KRIJIMIN TË POLITIKAVE

Dr. Misho Dokmanoviq



**KRIJIMI I KRITEREVE PËR CILËSI NË SHKENCAT SHOQËRORE NË FUNKSION TË
PARANDALIMIT TË LARGIMIT TË TRURËVE NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË**

DOKUMENT PËR KRIJIMIN TË POLITIKAVE

**KRIJIMI I KRITEREVE PËR CILËSI NË SHKENCAT SHOQËRORE NË FUNKSION TË
PARANDALIMIT TË LARGIMIT TË TRURËVE NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË
DOKUMENT PËR KRIJIMIN TË POLITIKAVE**

Botues:

Instituti për hulumtime strategjike dhe arsimim
www.isie.org.mk

Për botuesin

Dr. Misho Dokmanoviq

Autor

Dr. Misho Dokmanoviq

Lekturë

Shtypshkronja

Pan Computers & Print www.print.mk

Dizajn i kopertinës dhe përgatitje grafike

Aleksandra Noveska

Ky botim u mundësua me mbështetjen e programit CIVICA Mobilitas. Civika Mobilitas është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e zbatuar nga NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC) dhe Instituti Suedez për Administratë Publike (SIPU). Mendimet e shprehura në këtë publikim janë mendimet e autorit dhe jo gjithmonë pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

ABSTRAKT

Ky studim është përqendruar në vendosjen e kriterëve të qarta për cilësi në shkencat shoqërore në funksion të parandalimit të migrimit të studiuesve nga kjo zonë të Republikës së Maqedonisë.

Nëpërmjet një hulumtimi të bazuar në të dhëna parësore dhe dytësore, u vlerësuan kornizat ligjore ekzistuese për parandalimin e "largimit të trurëve" nga vendi dhe qëndrimet e grupit të synuar (shkencëtarë dhe studiues në shkencat shoqërore).

Dokumenti ofron disa rekomandime për hartuesit kryesorë të politikave, kryesisht të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë, universitetet dhe institucionet dhe organizatat e tjera.

1. HYRJE

Si shumica e vendeve të Evropës Lindore, Republika e Maqedonisë (RM) kohë të gjatë është duke u përballuar me sfidën e “largimit të trurëve”, dmth. migrimi i personave të lartëkualifikuar, nga arsye ekonomike dhe të tjera. Përveç ekzistencës së një migrimi intensiv të të gjitha kategorive të popullsisë, sondazhet e fundit tregojnë se numri i personave të kualifikuar dhe të arsimuar në fushën e shkencave shoqërore që largohen nga vendi, po rritet. Ky migrim jo-standard është karakteristik për vitet e fundit.

Një nga arsyet për këtë trend shqetësues është fakti se në vend nuk ka kriteret për atë se çfarë konsiderohet cilësore në shkencat shoqërore që sjell pasoja mbi legjislacionin (Ligji për arsimin e lartë, Ligji për punë shkencore, etj) që nuk krijojnë një kornizë në të cilën mund të përmirësohen mundësitë për studentët e suksesshëm për punësim dhe zhvillim të karrierës dhe në fund, të shprehjes të profesorëve universitarë, asistentët dhe hulumtuesit në vendin e tyre. Në të njëjtën kohë, këto zgjidhje ligjore janë subjekt i një ndryshimi të vazhdueshëm që vë në dyshim sigurinë ligjore të konstituentve tanë.

Në këtë drejtim, mungesa e një qasjeje të qëndrueshme për vlerësimin e cilësisë së hulumtimeve kontribuon për studiuesit mos të shohin perspektivë në mjediset e tyre dhe të emigrojnë. Një nxitje shtesë për të ngritur këtë çështje ishin forumet rajonale të CIVICA Mobilitas për rajonet Vardar, verilindje, lindje dhe juglindje të mbajtur në Sveti Nikole (14.07.2016) dhe në Shtip (10.07.2016) ku tema ishte reduktimi i migrimit, që na inkurajoi si një organizatë që punon në fushën e arsimit të lartë për të menduar në këtë drejtim.

Hulumtimi i kryer u përpoq t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme: (1) cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet grupi i synuar gjatë kryerjes së hulumtimeve në shkencat shoqërore? (2) a synon ky grup të largohet nga vendi? (3) cilat janë arsyet kryesore për “largimin e trurëve” nga Republika e Maqedonisë? (4) çfarë rol luajnë

kriteret e cilësisë në hulumtime? (5) nevojiten akte shtesë ose ndryshime në ato ekzistueset për të parandaluar largimin e kategorisë më të kualifikuar të popullsisë? etj. Përveç kësaj, arsyeja për kryerjen e hulumtimit është fakti se për një periudhë më të gjatë kohore kjo temë mungon nga diskutimi publik, veçanërisht pas miratimit të Strategjisë Kombëtare në vitin 2013.

Duke pasur parasysh këtë, ky hulumtim është përqendruar në një segment të veçantë të tregut të punës - individë me arsim të lartë në fushën e shkencave shoqërore dhe qëndrimet dhe perceptimet e tyre rreth mundësisë së migrimit jashtë vendit, veçanërisht në kuptim të arsyeve për të.

Në këtë drejtim, në bazë të hulumtimeve të bëra empirike, dokument përpiqet të ofrojë zgjidhje për zbatim më të mirë të Strategjisë për parandalimin e "largimit të trurëve", veçanërisht në fushën e shkencave shoqërore, dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut të gjerë në lidhje me këtë çështje të rëndësishme. Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë argumente të plotë dhe bindëse për të arsyetuar rekomandimet e përfshira në dhe si rezultat, të përmirësojë procesin e vendimmarrjes dhe ndërgjegjësimin e publikut, veçanërisht grupet e interesit për këtë çështje.

Sa i përket **metodologjisë** së hulumtimit, autorët u udhëzuan nga postulati se është jashtëzakonisht e rëndësishme për të përcaktuar efektivitetin e politikave ekzistuese për të analizuar qëndrimet e kategorive të cilave u takojnë këto politika. Mbi këtë bazë, u krijua një kornizë metodologjike që përfshinte burimet primare dhe sekondare të informacionit.

Burimet primare të informacionit bazohen në anketë e kryer me shkencëtarë, profesorë universiteti, bashkëpunëtorë dhe hulumtues që punojnë në fushën e shkencave shoqërore në Republikën e Maqedonisë.

Anketa me grupin e synuar u krye në periudhën prej 20 tetorit deri më 2 tetor 2017 në formë elektronike përmes një pyetësoi të standardizuar me gjithsej 17 pyetje. Anketa përfshi u një total prej 347 të anketuarish nga grupi i synuar, nga të cilat 81 ose 23.34% i u përgjigjën pyetjes së kërkuar. Vëmendje e veçantë u është kushtuar përgjigjeve për intervistimin e të anketuarve nga kryeqyteti, si dhe nga brendësia e vendit, dhe u bë kujdesë për përfaqësimin gjinor, etnik dhe fetar. Përfundimisht, përzgjedhja e të anketuarve i u përshtat formatit dhe kornizës kohore të projektit.

Në kuadër të këtij hulumtimi IHSA organizoi një tryezë të rrumbullakët mbi "Cilësisë në hulumtimet e shkencave shoqërore dhe parandalimin e largimit të trurëve nga RM: Mësimet e nxjerra dhe sfidat e së ardhmes", të mbajtur në tetor të vitit 2017 në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup. Në tryezat e rrumbullakëta u ftuan palët përkatëse me interes në këtë çështje: profesorë universiteti dhe asistentë, studiues, përfaqësues universitarë, ekspertë ligjorë, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues të organizatave qytetare etj.

Tryeza e rrumbullakët u inkorporua në projekt me qëllim që të prezantohen ë të dhënat paraprake nga sondazhi i kryer, të inkurajojë një debat publik mbi zgjidhjet aktuale ligjore, të prezantohen pikëpamjet e subjekteve të ndryshme të prekur me këtë çështje dhe për të mbledhur të dhëna për zbatimin e akteve që lidhen me parandalimin e "largimin e trurëve" nga vendi.

Burimet dytësore të informacionit u siguruan përmes një analize të kornizës aktuale ligjore në lidhje me parandalimin e largimit të trurëve nga Republika e Maqedonisë (rezolutat mbi Politikën e Migracionit të Republikës së Maqedonisë të miratuara nga Kuvendi për periudhën 2009-2014 dhe 2015-2020, Strategjia Kombëtare për rrjetëzim, bashkëpunim dhe zvogëlim të largimit të personelit të lartëarsimuar dhe ekspertëve 2013-2020, si dhe dokumenteve të tjera relevante.

Një dokument i vetëm nuk mund të zgjidhë të gjitha aspektet e një problemi, por mund të identifikojë sfidat kryesore dhe si rrjedhojë të ofrojë alternativa. Siç ndodh shpesh, në kuadër të hulumtimit u ballafaquam me kufizime të caktuara. Për pjesën më të madhe, kufizimet ishin të lidhura me sfidat logjistike, veçanërisht në drejtim të zgjidhjes të interesit të grupit të synuar (profesorë universiteti dhe hulumtues). Edhe duke i marrë parasysh kushtet e ndërlikuara të punës dhe kryerjes së hulumtimeve në fushën e shkencave shoqërore, shumica e hulumtuesve nuk iu përgjigjën pyetjeve të parashtuara (pothuajse 76% e të anketuarve të cilëve u dërgua anketa) duke treguar se për këtë kategori nuk ekziston interes. Këto kufizime na bëjnë veçanërisht të kujdesshëm në përcaktimin e rekomandimeve të këtij dokumenti.

2. PËRSHKRIMI I PROBLEMIT

Kjo pjesë e dokumentit është e ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë paraqet situatën aktuale, kornizën ligjore dhe politikat aktuale lidhur me parandalimin e "largimit të trurëve", me theks të veçantë në përshtatshmërinë e këtyre akteve për shkencat shoqërore. Pjesa e dytë paraqet rezultatet e hulumtimit të kryer empirik.

2.1. ANALIZA E SITUATËS SË TASHME, POLITIKAT AKTUALE DHE KUADRI LIGJOR

Në dekadën e fundit, trendi i migracionit nga rajoni i Evropës Juglindore rritej gjithnjë e më shumë. Ky trend nuk e kapërceu Republikën e Maqedonisë. Në këtë drejtim, trendi i migrimit nga Maqedonia në dhjetë vitet e fundit shënoi disa shenja që nuk ekzistonin më parë.

Së pari, për dallim nga e kaluara, shumë nga vala e emigrimit ka përfshirë profesionistët të lartëarsimuar dhe të suksesshëm, personelin universitar dhe hulumtuesit të cilët janë gjithnjë e më shumë zgjedhnin të largohen. Termi i pranuar gjerësisht si "largimi i trurëve" nënkupton transferimin ndërkombëtar të resurseve në formën e kapitalit njerëzor. Më konkretisht termi i referohet migrimit të fuqisë punëtore të lartëarsimuar dhe të kualifikuar nga vendet në zhvillim në vendet e zhvilluara. Sipas Stankoviq et al., pjesa më e madhe e emigracionit maqedonas është i lidhur me migrimin e punonjësve të kualifikuar. Trendi i emigrimit më intensiv të fuqisë punëtore të kualifikuar filloi gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Në këtë kontekst, më bindëse janë të dhënat se

numri i shkencëtarëve dhe studiuesve në periudhën 1995 - 2000 është ulur me 70 për qind.¹

Së dyti, duket se për këtë pyetje nuk ka interes dhe ndërgjegjësim më të madh midis hulumtuesve dhe autoriteteve shtetërore zyrtare dhe mbajtësve të interesave. Një periudhë e konsiderueshme pas pavarësisë dhe tranzicionit, Republika e Maqedonisë nuk miratoi një strategji për të parandaluar "largimin e trurëve" dhe statistikat për këtë çështje ishin ende të kufizuara, gjë që ishte i vazhdueshmisht nën kritikën e publikut. Në këtë drejtim, Horvat sugjeroi se në Maqedoni nuk ekziston vetëdije për problemin.²

Në të njëjtën kohë, numri i hulumtimeve në këtë temë është relativisht i vogël.³ Ky konstatim i referohet veçanërisht periudhës pas miratimit të Strategjisë Kombëtare, e cila do të diskutohet më poshtë në tekst. Hulumtimet mbi "largimin e trurëve" u përqëndruan më së shumti tek të rinjtë, ndonëse duket se ekziston një potencial i fuqishëm për emigrimin mes popullatës së mesme, një trend që tregon studimi ynë.

E treta, mungojnë të dhëna të besueshme për numrin e diasporës maqedonase. Sipas vlerësimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë, numri i emigrantëve nga Maqedonia në shtetet e jashtme është ndërmjet 565000- 600000, në vendet evropiane - 284600⁴. Sipas Diec, numri i diasporës maqedonase jashtë vendit arriti në 460000 qytetarë, ose 23% e

¹ Vangeli, A., Mehmedovic, N., Bakiu, B., National Report: Brain Drain in Macedonia: Scope and Factors, Center for Research and Policy Making, Skopje, April 2010, p. 1.

² Horvat, V., Brain Drain. Threat to Successful Transition in South East Europe?, Southeast European Politics, 2004, 5/1, p. 84.

³ Pavlov, T. (ed), *Brain Drain Policies and Practices in the Western Balkans*, Group 484 Centre for Migration, December 2013; Center for Research and Policy Making, *Developing Brain Gain Policies in Macedonia: Pitfalls and Challenges*, Available at: <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2012/03/Developing-Brain-Gain-Policies-in-Macedonia-Pitfalls-and-ChallengesOPTIM.pdf>; Vangeli, A., Mehmedovic, N., Bakiu, B., National Report: Brain Drain in Macedonia: Scope and Factors, Center for Research and Policy Making, Skopje, April 2010.

⁴ Republika e Maqedonisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RM, Strategjia kombëtare për rritje të bashkëpunimit dhe reduktim të largimit të personelit me arsim të lartë dhe profesional, 2013-2020, Shkup, 2013, në dispozicion na http://arhiva.vlada.mk/registar/files/Nacionalna_Strategjia_za_vmrezuvanje_sorabotka_i_namaluvanje_na_odlivot_na_visoko_obrazovani_i_strucni_kadri_2013-2020.pdf

popullsisë së përgjithshme të vendit⁵. Nga ana tjetër, sipas Raportit global mbi konkurrueshmërinë të Forumit Ekonomik Botëror për vitet 2016/17, Maqedonia renditet e 115-ta në botë në aspektin e kapacitetit për të mbajtur talentin⁶. Një trend i ngjashëm i emigrimit intelektual nga Maqedonia është identifikuar edhe në studimin "Ndikimi social i emigrimit dhe migrimit rural-urban në Europën Qendrore dhe Lindore", botuar në vitin 2015 nga Komisioni Evropian⁷.

Lidhur me mënyrat në të cilat shteti ka adresuar këtë çështje, duhet theksuar se vendi ka hapur këtë çështje me vonesë. Në vitin 2008, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi për herë të parë **Rezolutën për politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2009-2014**. Ky dokument ishte përpjekja e parë për të adresuar këtë çështje.

Në këtë dokument, ndër të tjerat, u theksua edhe obligimi i shtetit për të kthyer në vend anëtarët e diasporës maqedonase. Përveç kësaj, dokumenti sugjeronte se efektet negative të "largimit të trurëve" do të mund të tejkalohen përmes masave të mëposhtme: Hartim (mapping) i diasporës dhe krijim të një bazë të të dhënave për kategori të veçanta të emigrantëve (shkencëtarë, artistë dhe të tjerë), ku emigrantët vullnetarisht do të regjistrohenin, masa për të lehtësuar kthimin e qytetarëve të cilët rregullisht banojnë jashtë vendit, krijim i politikave për të zvogëluar emigrimin intelektual, për kthimin e personave me arsim të lartë nga jashtë si dhe zbutje të implikimet të pafavorshme nga emigrimi intelektual⁸. Përshkrimi i masave në rezolutë u përcaktua në përgjithësi pa aktivitete specifike për zbatimin e tyre. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ishte institucioni kryesor përgjegjës për këtë çështje^{9, 10}.

⁵ Dietz, B. (2010). Migration and remittances in Macedonia: A Review. Ost Europa Institut Regensburg, Working Paper No. 281, February 2010, p. 11.

⁶ World Economic Forum, The Global Competitiveness Report, 2016-2017, Available at http://www3.weforum.org/docs/GCR2016-2017/05FullReport/TheGlobalCompetitivenessReport2016-2017_FINAL.pdf

⁷ European Commission, Social Impact of Emigration and Rural-Urban Migration in Central and Eastern Europe, Available at <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=89&newsId=1778&furtherNews=yes>

⁸ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezoluta mbi politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2009-2014, dhjetor 2008, në dispozicion në http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/REZOLUCIJA_MIGRACIONA_POLITIKA.doc.

⁹ Ky dokument identifikoi 5 kategori aktorësh të lidhur me parandalimin e largimit të trurëve nga vendi.

¹⁰ Idem, стр. 41.

Në vitin 2015, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë përsëri miratoi një **Rezolutë mbi politikën e migracionit për periudhën 2015-2020**. Kjo rezolutë ka identifikuar në mënyrë të qartë problemin e "largimit të trurëve" dhe si rezultat, ulja e intensitetit të emigracionit të përhershëm, sidomos të emigracionit intelektual, duke adresuar vazhdimisht shkaqet e shprehura për qëllimet migratore, është themeluar si objektiv i parë strategjik të politikës së migracionit¹¹. Megjithatë, duhet theksuar se ky dokument ishte i përqendruar në emigrimin e personelit mjekësor dhe inxhinierik, i cili u theksua qartë në dokument.

Përveç kësaj, duhet theksuar se një hap i madh përpara në drejtim të parandalimit të "largimit të trurëve" nga vendi është arritur me miratimin e Strategjisë Kombëtare për ndërrjetësim, bashkëpunim dhe për të zvogëluar largimin e personelit me arsim të lartë dhe profesional 2013- 2020. Në kuadër të hulumtimeve në lidhje me përgatitjen e kësaj strategjie, u përcaktua se arsyet më të zakonshme pse njerëzit të rinj vendosin të largohen nga vendi janë: pagat e ulëta, paqëndrueshmëria dhe pasiguria ekonomike, mundësi të kufizuara për avancim në karrierë, presioni politik dhe mungesa e fondeve dhe mundësive për fillimin e biznesit. Si zgjidhje të mundshme për këto sfida janë ofruar: investime në objektet e reja për veprimtari shkencore-hulumtuese, rritja e pagave, përfshirja e individëve të cilët punojnë jashtë vendit në proceset arsimore, shkencore dhe të biznesit në vend; reforma serioze në proceset e punësimit dhe eliminimi i ndikimeve nga ana familjare-miqësore, parti politike, fushata mediatike etj.¹²

Strategjia gjithashtu identifikoi problemin që institucionet maqedonase të arsimit të lartë nuk po marrin masa për të parandaluar largimin e trurëve. Krijimi i një politike për uljen e largimin e trurëve u theksua edhe një herë si një nga masat më të rëndësishme. Ky dokument ofroi një sërë masash për të adresuar këtë sfidë duke përfshirë: krijimin dhe menaxhimin e një databaze të emigracionit intelektual nga RM; krijimi i një forumi të ekspertëve maqedonas jashtë vendit; organizimi i ngjarjeve promovuese për afirmimin e politikës; animimi i opinionit publik përmes një serie emisionesh; bursa për qëndrim dhe studim jashtë vendit për individë me

¹¹ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezoluta mbi politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2015-2020, janar 2015, fq. 46

¹² Idem, fq. 16.

arsim të lartë në shkencat teknike dhe mjekësi; mbështetje dhe pjesëmarrje e sektorit privat në reduktimin e largimit të trurëve; punësimi në organet e administratës shtetërore, optimizimi i numrit të studentëve në drejtime të caktuara nga shkencat shoqërore në universitete, grante dhe investimet në infrastrukturë, rritja e shkëmbimit intelektual etj.

Me përjashtim të programit të bursave dhe zhvillimit të laboratorëve në periudhën e kaluar, nuk u ndërmorën masa të tjera konkrete për të adresuar këtë sfidë. Përveç kësaj, deri tani nuk është bërë asnjë analizë e ndikimit të rregullores mbi "largimin e trurëve", veçanërisht në aspekt të efekteve specifike të dokumenteve të miratuara.

Së fundi, duhet të theksohet se perceptimi i përgjithshëm i pranishëm në publik se "largimi i trurëve" prek kryesisht shkencat teknike, natyrore dhe mjekësore janë pasqyruar në dokumentet e miratuara kombëtare. Kështu, për shembull, vetë Rezoluta mbi politikat e migracionit të RM nga viti 2008 ka theksuar se "më i madh është numri i të rinjve me arsim të lartë dhe studentë të viteve të fundit të fakulteteve të shkencave teknike dhe natyrore që janë marrë parasysh ose planifikojnë për të shkuar jashtë vendit." ¹³ Në rezolutën e vitit 2015 ky trend ruhet dhe dokumenti sugjeron se pjesë e madhe e largimit të trurve përbëjnë inxhinierët dhe mjekët.¹⁴

Në tërë strategjinë, shkencat shoqërore përmenden vetëm në kontekstin e optimizimit të numrit të studentëve dhe numrit të profileve arsimore të financuara nga shteti. Kjo ishte gjithashtu një arsye shtesë për të vlerësuar potencialin për migrim në kategorinë më të lartë të arsimuar të popullsisë në fushën e shkencave shoqërore përmes hulumtimit të kryer.

¹³Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezoluta mbi politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2009-2014, dhjetor 2008 e disponueshme në http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/REZOLUCIJA_MIGRACIONA_POLITIKA.doc, fq 4.

¹⁴ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezoluta mbi politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2015-2020, janar 2015, fq. 13

3. HULUMTIM EMPIRIK

Siç u theksua në prezantimin e këtij studimi, burimet parësore për nevojat e hulumtimit u mbledhën nëpërmjet një sondazhi me persona që merren me hulumtime në fushën e shkencave shoqërore në RM. Më konkretisht, në kapacitetin e të intervistuarve u përfshinë mësuesit dhe bashkëpunëtorët e universiteteve publike dhe private në vend, hulumtuesit që kryejnë kërkime në fushën e shkencave shoqërore në organizatat e shoqërisë civile, si dhe individë. Në kuadër të hulumtimit u përgatit një listë adresash elektornike të mësuesve dhe bashkëpunëtorëve të ueb-faqeve të universiteteve publike dhe private¹⁵. Në të njëjtën kohë, është bërë një listë e organizatave relevante të shoqërisë civile dhe hulumtues që merren me hulumtime në shkencat shoqërore.

Në bashkëpunim me Dr. Majkëll Oksner, Hulumtues i lartë në Qendrën Zvicerane për Shkencat Shoqërore në Llozanë, u përgatit një anketë. Anketa u përqëndrua në perceptimet që lidhen me migracionin, arsyet për migracionin dhe kushtet e përgjithshme për kryerjen e punës shkencore dhe kërkimore. Kriteret e cilësisë janë përfshirë në një studim të veçantë dhe janë analizuar në mënyrë të pavarur nga kjo anketë.

Anketa përmbante 17 pyetje dhe u zhvillua në mënyrë elektronike në periudhën prej 20 shtatorit deri më 2 tetor 2017.

Përveç kësaj, në kuadër të hulumtimit më 4 tetor, 2017, në universitetin "Shën Kirili dhe Metodi", Fakulteti i Drejtësisë "Justinian Prvi" në Shkup u organizua një tryezë e rrumbullakët me konstituentët tanë për rezultatet e anketës dhe

¹⁵ Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore, një nga kushtet për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë është mirëmbajtja e një faqe interneti.

mundësinë e përfshirjes së tyre në legjislacionin e ri, e cila u ndoq nga 40 profesorë universitarë, asistentë dhe studiues, si dhe nga një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të RM. Përveç tryezës së rumbullakët, u mbajt trajnim për hulumtues të rinj që u ndoq nga 75 pjesëmarrës të cilët u njohën me parimet kryesore të konceptit të cilësisë në shkencat shoqërore. Të dyja ngjarjet janë organizuar në bashkëpunim me Qendrën Zvicerane për ekspertizë në shkencat shoqërore nga Llozana.

3.1. Rezultatet e anketës


Pyetëtori i anketës u dërgua deri tek 347 individë, nga të cilët 81 ose 23.34% iu përgjigjën pyetjeve. Standardi i pranuar përgjithësisht për përqindjen e të anketuarve në këtë lloj të anketave është midis 20 dhe 25% dhe është i plotësuar. Më poshtë janë përmbledhur statistikatat për mostrën.

Tabela 1



Sa i përket profesionit, 73,5% e të anketuarve janë profesorë universiteti dhe asistentë, ndërsa 22,5% janë hulumtues. Sa i përket gjinisë së të anketuarve, 59.26% ishin femra dhe 40.74% femra. Sa i përket strukturës së moshës, shumica e të anketuarve ishin të moshës 31-45 vjeç (58,02% e të anketuarve), pasuar nga të intervistuarit 45-60 vjeç (29,63%), në moshën 18-30 vjet ishin 9,88% të të anketuarve, dhe nga grupmosha mbi 60 vjeç morëm vetëm dy përgjigje. Sa i përket përkatësisë kombëtare të të anketuarve, 86,42% u deklaruan si maqedonas; 6,17% si shqiptarë; 3,7% turq, 2,47% - të tjerë dhe ,23% serbë. Brenda përkufizimit të mostrës, është ngritur një pyetje për të ardhurat mujore neto të të anketuarve. Në këtë drejtim, të ardhura mujore prej 300-500 euro kanë 27,16% të të anketuarve, të ardhura nga 500-700 euro kanë 33,33%, dhe nga 700 - 1000 euro - 23,46% të të anketuarve. Vetëm 14,81% e të anketuarve kanë të ardhura neto mujore mbi 1000 euro.


Tabela 2



Duke marrë parasysh karakteristikat e mostrës të përmendura më parë, do të kalojmë në analizën e përgjigjeve në pyetjet e bëra. Në pyetjen e parë: "Nëse keni mundësi, a do të largoheni nga atdheu juaj dhe a do të jetoni jashtë vendit", 68,75% kanë dhënë një përgjigje pozitive. Kjo pyetje është përgjigjur negativisht


nga 27,5% të të anketuarve. Shumica e të anketuarve që dhanë përgjigje pozitive për këtë pyetje do të shkonin në Evropë (77,42%) dhe një përqindje më e vogël në Amerikën e Veriut (33,87%) dhe Australia (14,52%). Përveç kësaj, të anketuarit të cilët i dhanë një përgjigje pozitive çështjes së largimit nga atdheu, u pyetën "sa kohë do të kishin qëndruar jashtë vendit?". Pjesa më e madhe (44,44%) dha përgjigjen se do të qëndronin jashtë vendit përgjithmonë. Një përqindje më e vogël do të qëndronte për dhjetë vjet ose më shumë (15,87%), apo pesë vjet (17,46%).

Tabela 3



Përveç gatishmërisë dhe të menduarit rreth largimit, hulumtimi i kryer ishte për të përcaktuar nëse kjo kategori e të anketuarve ka ndërmarrë veprime konkrete për të dalë nga vendi. Në këtë drejtim, 19,74% e të anketuarve kanë marrë aktivitete konkrete për largimin nga vendi dhe pjesa tjetër (80,26%) e kësaj pyetjeje dha një përgjigje negative.

Tabela 4



Pjesa e dytë e hulumtimit ishte e përkushtuar ndaj perceptimit të përgjithshëm të largimit të trurëve. Rreth 45% e të anketuarve kanë anëtarë të familjes së ngushtë që jetojnë jashtë vendit. 55% kanë dhënë një përgjigje negative në këtë pyetje.

Për të përcaktuar alternativat e mundshme në lidhje me çështjen e interesit, është gjithashtu e rëndësishme të përcaktohen arsyet për largimin. Për pyetjen "Pse njerëzit e vendit tuaj vendosin të jetojnë jashtë vendit?", një pyetje që të anketuarit mund të zgjedhin më shumë se një përgjigje, shumica e të anketuarve kanë identifikuar arsyet e mëposhtme: numri i vogël i mundësive (53,09%), stili më i mirë i jetës (48,15%), paqëndrueshmëria politike (32, 1%) dhe presioni në shoqëri (32.15%).

Tabela 5






Tabela 6



Hulumtimi i kryer u përpoq të përcaktojë arsyet pse vetë pjesëmarrësit do të largoheshin nga vendi. Dhe për këtë çështje të anketuarit mund të jepnin më shumë se një përgjigje. Në këtë drejtim, shumica do të largoheshin nga vendi për shkak të "ndjenjës se asgjë nuk po ndryshon në shtet" (55,7%). Përveç kësaj, si arsye personale për largimin nga vendi u identifikuan "shkaqet personale" (39,24%), "numri i ulët i mundësive" (35,44%), "paqëndrueshmëria politike" (27,85%), etj.

Një tregues shtesë i disponimit të grupit të të anketuarve ishte gjithashtu pyetja "a do të pranoni punën jashtë vendit që nuk korrespondon me kualifikimet e tyre?". Në këtë pyetje, rreth 43,21% e të anketuarve kanë dhënë përgjigje pozitive, ndërsa 53,09% kanë dhënë përgjigje negative.

Tabela 7



Një vend i rëndësishëm në hulumtim u kushtua përcaktimit të kushteve në të cilat punojnë hulumtuesit në fushën e shkencave shoqërore dhe, si rrjedhojë, ndikimin e tyre në largimin e trurëve nga vendi. Në këtë drejtim, pyetja "a investojnë mjaftueshëm autoritetet në vendin tuaj në hulumtim dhe zhvillim?" Të gjithë të anketuarit dhanë një përgjigje negative identike (100%). Një tendencë e ngjashme është gjithashtu e pranishme në financimin e projekteve kërkimore në fushat përkatëse për hulumtuesit. Për pyetjen "A keni qasje në fonde për projekte kërkimore në zonën tuaj?", 59,96% e të anketuarve dhanë përgjigje negative. Një e treta e të anketuarve, përkatësisht 33.33%, thanë se sigurojnë fonde nëpërmjet informacionit ndërkombëtar. Kjo sugjeron që si rezultat i mungesës afatgjatë të financimit, hulumtuesit në shkencat shoqërore janë të orientuar drejt sigurimit të fondeve nga burime të huaja.

Tabela 8



Tabela 9



Përveç kësaj, në kuadër të vlerësimit të performancës së punës hulumtuese, vlerësimi më i dobët i të anketuarve iu kushtua kushteve, burimeve dhe pajisjeve për punë (1,91), si dhe pagës (2,1). Vlerësime relativisht më të larta iu dhanë mundësive të zhvillimit të karrierës (2,7) dhe mundësive profesionale jashtë vendit (2,78). Vlerësimi më i lartë i të anketuarve fitoi liria e hulumtimit (3,3).

Gjatë përgatitjes së pyetësorit kemi pasur njohuri dhe shpresë fillestare se paga do të identifikohet si një sfidë kryesore në avancimin e pozitës së hulumtuesve në shoqëri dhe, rrjedhimisht, mbajtjen e tyre në vendin tonë. Si rezultat, në pyetjen "Të jesh i kënaqur me pagën tënde, e njëjta duhet të rritet", morëm përgjigjet e mëposhtme: "10-20%" - 7.5% e të anketuarve; "nga 20-50%" - 15% e të anketuarve; "nga 50-80%" - 31,25% e të anketuarve, dhe 18,75% e të anketuarve deklaruan për rritjen e pagave të "80-100%". Vetëm 3.75% e të anketuarve konsiderojnë se paga nuk duhet të rritet.

Tabela 10





Tabela 11



Në kontekstin e situatës së të anketuarve në shoqëri, u parashtrua pyetja e perceptimit të tyre për situatën në shoqëri. Ne morëm shumë përgjigje konflikte në këtë pyetje. 59,49% e të anketuarve mendonin se ata kishin "status të lartë ekonomik" në shoqëri, ndërsa 30,38% mendonin se ata kanë status të ulët ekonomik në shoqëri.

Një ndarje e ngjashme ishte gjithashtu e pranishme në aspektin e mundësive për zhvillimin e karrierës. Në këtë drejtim, 51,85% e të anketuarve raportuan se ata "përparojnë në një farë mase", 9,88% - se "përparojnë në masë të madhe" dhe 4,94% "përparojnë tërësisht". Megjithatë, 23,46% e të anketuarve deklaruan se "përparojnë pak" dhe 9.88% - se mbesin mbrapa profesionalisht.

Së fundi, në pyetjen "Ku e shihni veten për 5 vjet?", 69,14% e të anketuarve u përgjigjën se ata shihen në vendin e tyre dhe 27,16% - jashtë vendit. Kjo përgjigje tregon për potencialin e madh për emigrimin e kategorisë së popullsisë më të arsimuar në shkencat shoqërore.

Në mënyrë që të marrë një pamje më të detajuar se si punësimi i institucioneve që merren me hulumtime në shkencat shoqërore në pyetjen "a jeni përballuar me sfida gjatë punësimit tuaj?" Shumica e të anketuarve dhanë përgjigje negative (58,02%) . Kjo tregon tendencën që individët më të arsimuar në shkencat shoqërore nuk përballen më së shumti me sfida në bazë të punësimit. Megjithatë, për këtë pyetje janë dhënë edhe përgjigje pozitive siç vijon: mungesa e interesit për dijen dhe arsimin tim (17,28%), është kërkuar që të jam anëtar i një partie politike (7,41%), kam marrë punën nëpërmjet nepotizmit dhe "lidhjeve"(4,94%), për shkak të moshës sime (3,70%). Nga këto të dhëna, është e qartë se ende ekzistojnë praktika korruptive në punësim dhe se në një numër i konsiderueshëm të rasteve ka mungesë interesi për njohjen dhe arsimin e hulumtuesve.

Tabela 12




Tabela 13






Tabela 14



Duke pasur parasysh se qëllimi i hulumtimit është vlerësimi i ndikimit të përcaktimit të kriterëve të cilësisë së largimit, disa pyetje janë fokusuar në këtë aspekt. Kjo u konfirmua nga përgjigjet e disa pyetjeve. Në këtë kuptim, pyetja "A mendoni se standardet e hulumtimit cilësor në zonën tuaj janë të përcaktuara qartë?" Pothuajse dy të tretat e të anketuarve (65,43%) dhanë përgjigje negative. Pjesa tjetër e të anketuarve konsideron se në fusha përkatëse "ka disa kriterë të cilësisë" (23,46%), dmth se në fusha përkatëse "ekzistojnë kriterë dhe standarde të qarta dhe të njohura për cilësi në hulumtim" (8,64%). Përcaktimi i kriterëve të cilësisë mund të jetë një kriter kyç për financimin e kërkimit shkencor në shkencat shoqërore.

Tabela 15



Sondazhi i kryer përfshiu pyetje që lidhen me zhvillimin e politikave në nivel kombëtar dhe institucional për parandalimin e largimin e trurëve. Lidhur me këtë, 88.75% deklaruan se në institucionin e tyre nuk ekziston asnjë politikë për parandalimin e largimin e trurëve. Përveç kësaj, 8.75% treguan se "institucioni i tyre kujdeset për parandalimin e "largimin e trurëve", por nuk ka akte dhe/ ose procedura formale për këtë çështje."

Pikëpamjet kritike mbi potencialin e migrimit të kategorisë së profesorëve universitarë, shkencëtarë dhe hulumtues nga shkencat shoqërore u prezantuan në tryezën e rrumbullakët që u mbajt në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, më 4 tetor 2017. Tryeza e rrumbullakët u ndoq nga 34 pjesëmarrës: dekanë, profesorë universitarë dhe asistentë, hulumtues, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, duke përfshirë organizatat studentore, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe ekspertë të Qendrës zvicerane për ekspertizë në shkencat shoqërore, Dr. Majkëll Oksner.

Tabela 16





Tabela 17





Pas prezantimit të të dhënave paraprake nga anketa, u zhvillua diskutim i cili formuloi përfundimet e mëposhtme: (1) ekziston shqetësim serioz tek profesorët universitarë dhe bashkëpunëtorët për burimet që janë në dispozicion për të kryer hulumtime; (2) ka pakënaqësi në aspektin e të ardhurave mujore të cilat kanë një ndikim të madh në cilësinë e jetës; (3) ka nevojë urgjente për të nxitur bashkëpunimin me partnerët e huaj dhe "know-how" të huaj në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e hulumtimit dhe (4) shteti duhet të marrë kujdes të veçantë për personelin të ri të kualifikuar që kthehej nga studimet (magjistraturë dhe doktoraturë) nga jashtë dhe t'u ofrojë atyre mundësi të përshtatshme për arsimimin e tyre dhe aftësitë e fituara.

Konkluzione dhe rekomandime

Bazuar në hulumtimin empirik të kryer dhe analizën e dokumenteve relevante kombëtare lidhur me largimin e trurëve, mund të konkludojmë si në vijim:

- Në RM është krijuar potencial për migrim të profesionistëve me arsim të lartë nga shkencat shoqërore. Kjo e rrënon stereotipin aktual në opinionin maqedonas se potenciali i migrimit ekziston kryesisht në fushën e shkencave teknike dhe mjekësore. Anketa tregoi se 68,75% e të anketuarve do të largoheshin nga vendi dhe do të jetonin jashtë vendit nëse do t'u jepej mundësia. Në të njëjtën kohë, 27,16% e të anketuarve janë parë jashtë vendit në pesë vjetët e ardhshëm.
- Kategoria e popullsisë më e arsimuar tregon interes të lartë për migrim. Pothuajse 20% e të anketuarve kanë ndërmarrë aktivitete konkrete për t'u larguar nga vendi dhe mbi 40% e të anketuarve do të pranonin punën jashtë vendit që nuk korrespondon me kualifikimet e tyre.
- Shumica e të anketuarve që mendojnë për migrim do të qëndronin jashtë vendit për një periudhë më të gjatë kohore.
- Dokumentet e miratuara në nivel kombëtar nuk reflektojnë në mënyrë adekuate situatën reale në lidhje me potencialin për emigrim nga vendi dhe të njëjtat janë të kufizuara vetëm në shkencat teknike dhe mjekësore
- Është katastrofale që të gjithë të anketuarit (100%) kanë dhënë një përgjigje identike negative për pyetjen nëse autoritetet investojnë mjaftueshëm në hulumtim dhe zhvillim.

- Mbi dy të tretat e të anketuarve konsiderojnë se kriteret për cilësi në fushën përkatëse nuk janë të përcaktuara qartë.
- Nuk ekzistojnë politika, formalë apo joformalë, për të parandaluar "largimin e trurëve" në nivel universitar.
- Në shumicën e rasteve, të anketuarit deklaruan se nuk janë përballuar me sfida në punësim, por si do qoftë ekzistojnë praktikat korruptive të punësimit, duke përfshirë kërkesë për anëtarësim në parti politike dhe nepotizëm. Në një numër të konsiderueshëm të rasteve nuk kishte interes në dijen dhe edukimin e të anketuarve.
- Në fushën e treguesve të cilësisë së jetës, hulumtimi e bërë tregon se hulumtuesit më së shumti e identifikojnë të njëjtën gjë me shumën e të ardhurave mujore dhe për pjesën më të madhe kërkojnë një rritje të konsiderueshme të pagave, që është mbi 50%.

Bazuar në hulumtimin e kryer, janë identifikuar rekomandimet e mëposhtme:

a.) Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë

- Të rishqyrtohen dokumentet ekzistuese kombëtare që kanë të bëjnë me çështjen e migracionit. Ato duhet të përshtaten me kushtet reale në të cilat ky hulumtim u përqendrua, në veçanti potencialit për migrim në shkencat shoqërore.
- Të rivlerësojë nevojën në dokumentet kombëtare të bëhen dallime të qarta në lidhje me potencialin e migrimit në fusha të ndryshme shkencore.
- Të zbatohen masat e parashikuara në dokumentet kombëtare për parandalimin e "largimin e trurëve".
- Të merren masa për përmirësimin e kushteve, burimet dhe mundësitë për të kryer punë shkencëtare kërkimore, si dhe rritje të konsiderueshme mujore të pagave tek kategoria e popullsisë me arsim më të lartë.
- Të nisët një proces për vendosjen e kriterëve për cilësi në hulumtime përmes pjesëmarrjes së dukshme dhe thelbësore të komunitetit akademik.
- Vazhdimisht të ndjekën potencialet tona hulumtuese jashtë vendit (studiuues të rinj, por edhe shkencëtarë të moshës së mesme) dhe të krijohen kushte për tërheqjen e tyre në atdhe

b.) Universiteteve / institucioneve hulumtuese

- Të promovohet investiminë hulumtime dhe zhvillimin shkencor, si dhe të merren masa për të motivuar shkencëtarët e lartë në universitete dhe institucione.
- Të miratohen dokumente dhe/ ose politika për të parandaluar "largimin e trurëve" nga universitetet.
- Të merren masa për të eliminuar praktikrat korruptive të punësimit duke përfshirë nepotizmin dhe përkatësinë politike.
- Të promovohet debati publik për këtë çështje në mjedisin akademik.

Bibliografi

Center for Research and Policy Making, *Developing Brain Gain Policies in Macedonia: Pitfalls and Challenges*, Available at: http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2012/03/Developing-Brain-Gain-Policies-in-Macedonia_Pitfalls-and-ChallengesOPTIM.pdf.

Dietz, B. (2010). Migration and remittances in Macedonia: A Review. Ost Europa Institut Regensburg, Working Paper No. 281, February 2010.

European Commission, Social Impact of Emigration and Rural-Urban Migration in Central and Eastern Europe, Available at <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=89&newsId=1778&furtherNews=yes>

Horvat, V., Brain Drain. Threat to Successful Transition in South East Europe?, Southeast European Politics, 2004, 5/1.

Pavlov, T. (ed), *Brain Drain Policies and Practices in the Western Balkans*, Group 484 Centre for Migration, December 2013.

Stankovic, M., Angelova, B., Janeska, V., Stankovic, B., Brain Drain as Brain Gain in Southeast Europe: Challenges Ahead, ICIE2013-International Conference on Innovation, conference proceedings, 2013.

Vangeli, A., Mehmedovic, N., Bakiu, B., National Report: Brain Drain in Macedonia: Scope and Factors, Center for Research and Policy Making, Skopje, April 2010.

World Economic Forum, The Global Competitiveness Report, 2016-2017,
Available at http://www3.weforum.org/docs/GCR2016-2017/05FullReport/TheGlobalCompetitivenessReport2016-2017_FINAL.pdf

Republika e Maqedonisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RM, Strategjia kombëtare për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e largimit të personelit të lartë arsimor dhe profesional, 2013-2020, Shkup, tetor 2013, në dispozicion në http://arhiva.vlada.mk/registar/files/Nacionalna_Strategjia_za_vmrezuvanje_sorab_otka_i_namaluvanje_na_odlivot_na_visoko_obrazovani_i_strucni_kadri_2013-2020.pdf

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezoluta mbi politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2009-2014, dhjetor 2008, në dispozicion në http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/REZOLUCIJA_MIGRACIONA_POLITIKA.doc.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezoluta mbi politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2015-2020, janar 2015





CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.346.32-053.6

ДОКМАНОВИЌ, Мишо

Воспоставување на критериуми за квалитет во општествените науки во функција на спречување на одливот на мозоци од Република Македонија : документ за креирање на политики / [автор Мишо Докмановиќ]. - Скопје : Институт за стратешки истражувања и едукација - ИСИЕ, 2017. - 30, 30 стр. : илустр. ; 21 см

Насловна страна на припечатениот текст: Themelimi i kriterëve të cilësisë në shkencat shoqërore në funksion të parandalimit të largimit të trurëve nga Republika e Maqedonisë / Miso Dokmanoviq. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 23-24

ISBN 978-608-65157-8-2

а) Младинска политика - Миграција на млади - Македонија

COBISS.MK-ID 105496074

